

VENDIM
Nr.174, datë 18.3.2010

PËR PJESËMARRJE NË OPERACIONIN USHTARAK NTM-I (NATO TRAINING MISSION IRAQ)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të pikës 6 të nenit 14 të ligjit 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision, në operacionin ushtarak NTM-I (NATO Training Mission Iraq), të dy ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Misioni është edukimi dhe trajnimi i personelit të forcave të sigurisë irakiane, pranë komandës irakiane të stërvitjes.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është 2 (dy) vjet.

4. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, shpenzimet, përkatësisht, për:

- shpërblimin për vështirësi shërbimi, në masën 9000 (nëntë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

- akomodimin (fjetje, ngrohje, ujë);

- ushqimin;

- energjinë elektrike dhe luanterinë;

- qiranë e magazinimit;

- karburantin;

- evakuimin mjekësor;

- siguracionin, mirëmbajtjen dhe riparimet e automjetit, siguracionin shëndetësor, telefoninë fikse dhe të lëvizshme, përkthyesin;

- çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha